

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

17.01.2023
Ora 13:10

RENDI I DITËS

*Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesës ankimore nr. 12, 13, 14, 17, 18, 19, 20,
21, 22, 23, 25, 26 dhe 27.*

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirja RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Z. Erdal Mema, Znj. Kejsa Bici.
- **Të tjerë:** Z. Mustafa Gjinaj, Z. Aristotel Petro, Z. Sidi Hodo
KRIIK

Z. L. Braho: Sot më datë 17.01.2023 çelet seanca publike e shqyrtimit administrativ të kërkesave ankimore nga numri 12 që i përket Mat Televizion deri tek numri 27 që i përket televizionit Kukësi Sha. Konkretisht kemi kërkesat ankimore nga Mat Televizion, Club Tv, A2 CNN, Tv Klaudio, Radio Televizioni Saranda, Tv Berati, Glob TV, AMGB 2000 Sh.p.k, Apollon Tv, Televizioni Koplik, Tv Best Sh.p.k, Era Digital sh.p.k dhe televizioni Kukësi Sha të paraqitura brenda afatit ligjor, brenda afatit 3 ditor në data të ndryshme në KQZ. Ndërkohë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin numër 224 të datës 7.12.2022 për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, në mbështetje të neneve 19 pika 1 shkronja e dhe pika 2 shkronja e të Kodit Zgjedhor ka vendosur marrjen e masave administrative me gjobë ndaj disa ofruesve të shërbimit mediatic televiziv. Sipas vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve objekt i ketyre ankimimeve administrative ndër të tjera ka rezultuar se nga verifikimi

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

i monitorimit të fushatës në media 54 subjekte ose OSHMA janë në shkelje të nenit 84, pika 5 të Kodit Zgjedhor e për rrjedhojë për secilën prej tyre është marrë masa administrative me gjobë. Në zbatim të nenit 171 pika 1 të Kodit Zgjedhor masen nga 30 mijë deri në 50 mijë lekë. Dy OSHMA janë në shkelje të nenit 84 pika 6 të kodit zgjedhor dhe për to është marrë masa administrative në zbatim të nenit 171 pika 1 të Kodit Zgjedhor në masën 70 mijë lekë. Dhe 5 OSHMA janë në shkelje të nenit 92/6 pika 6 të Kodit Zgjedhor dhe për to është marrë masa në zbatim të nenit 173 pika 8 të Kodit Zgjedhor në masën 100 mijë lekë. Ndaj këtij vendimi kanë bërë ankim subjektet e sipërcituara. Në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor këto kërkesa ankimore janë regjistruar në regjistrin e ankimeve. Për to është hedhur shorti dhe po ashtu janë pranuar për kalim në shqyrtim. Është bërë bashkimi i kërkesave ankimore në zbatim të nenit 142 të Kodit Zgjedhor dhe tashmë kemi shqyrtimin administrativ të secilës prej tyre por që do të bëhet bashkarisht. I jap fjalën përfaqësuesit të KQZ-së në lidhje me këto kërkesa ankimore. Zoti Merkaj, t'i citojmë një për një kush janë argumentet për të cilat është vendosur dënimi administrativ dhe pastaj, për secilën që ka përfaqësues nga ankimesit të japin pretendimet e tyre. Për ato që nuk ka përfaqësues të takon ty që të na paraqesësh ankimin dhe pastaj i japim fjalën sërish për vendimet përfundimtare, faleminderit.

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin numër 224 datë 7.12.2022 ka miratuar raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara, të shpenzuara nga partite politike pjesëmarrëse të datës 25 Prill 2021. Në përfundim të procesit administrativ duke qenë se disa nga televizionet OSHMA nuk kanë dorëzuar tarifat e përcaktuara nga neni 84, pika 5 i Kodit Zgjedhor ka marrë masën e gjobës për Tv Mat duke e dënuar me 30 mijë lekë për shkelje të këtij neni.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. L. Braho: Ka përfaqësues nga Tv Mat?

Z. M. Gjinaj: Jam përfaqësues për Tv Matin direkt sepse nga Tv Mat u morën vesh edhe gjopa të tjera të subjektit, përndryshe nuk do ishte marë vesh asnjë.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! Vazhdoni me pretendimet që keni në lidhje me ankimin

Z. M. Gjinaj: Në lidhje me ankimin nuk bie dakord me masën administrative për këto arsye. Së pari Tv Mat ka njoftuar siç e përcakton ligji 2 javë përpara për të paraqitur kërkesën. Në television nuk është paraqitur asnjë kërkesë me shkrim për reklama politike, as subekteve dhe as individëve. Në këto kushte kur nuk ka pasur, çfarë do të paraqiste? S'ka patur kërkesë absolutisht në TV Mat. Dhe në këto kushte nuk kishte çfarë kërkesë të dorëzonte në KQZ. Për pjesën tjetër në Tv Mat nuk është paraqitur asnjë subjekt politik gjatë fushatës, AMA nuk ka asnjë minutë të evidentuar që Tv Mat ka bërë një shkelje, nuk ka një faturë në Tv Mat që një subjekt politik ka qënë pjesë e Tv Mat për reklama. Kështu që unë mendoj që janë faktet dhe arkumentet për ta rrëzuar masën administrative..

Z. L. Braho: Po, faleminderit. Zoti Merkaj në lidhje me këtë pretendimin që ankuesi ngriti duke thënë që nuk ka transmetuar asnjë reklamë, nuk ka pasur asnjë kërkesë nga asnjë subjekt politik, keni ndonjë koment?

Z. Y. Merkaj: Neni 84, pika 5 e Kodit Zgjedhor parashikon se operatorit radioteleviziv i detyrohet të dorëzojë 5 ditë përpara fillimit të fushatës tarifat për çdo

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

segment kohor pranë KQZ. Tarifat publikohen në faqen zyrtare të internetit të KQZ. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përpara fillimit të fushatës i ka dërguar të gjithë televizioneve përfshirë edhe TV Mat një kërkesë për të dorëzuar tarifat zyrtare. Kërkesës tonë nuk i është përgjigjur TV Mati dhe shumë televizione të tjera.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit!

Z. I. Rusmali: Kisha një pyetje për përfaqësuesin e subjektit, ju i keni bërë ofertë partive politike ose me saktë i keni bërë kërkesë 20 ditë përpara. Këtë kërkesë e keni bërë me postë, me shkrim në internet, me njoftim në gazetë, si e keni bërë këtë njoftim?

Z. M. Gjinaj: Në Tv Mat është bërë kërkesa qoftë nëpërmjet kontakteve direkt të administratorit siç ndodh gjithmonë, është bërë edhe me shkrim subjekteve për t'u paraqitur 2 javë përpara siç e do Kodi Zgjedhor. Por nuk është paraqitur askush.

Z. I. Rusmali: Formën dua të di. I dërguat e-mail, ja dërguat me postë, si ja dërguat?

Z. M. Gjinaj: Me të treja format.

Z. I. Rusmali: Me shkrim si? Ja dërguat në seli?

Z. M. Gjinaj: Po! Në zbatim të ligjit, për reklamat politike nga kjo datë në këtë datë, pra 5 ditë para se sa ne të dërgonim materialin të paraqiteshin. Përderisa nuk erdhi askush edhe ne nuk dërguam gjë.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. I. Rusmali: Kopje të kësaj shkresës mund të na vini në dispozicion?

Z. M. Gjinaj: Këtu nuk e kam me vete sepse nuk e dija që mund të më duhet. Një moment të dytë mund t'ua dërgoj.

Z. I. Rusmali: Po njeri atje në zyrë keni?

Z. M. Gjinaj: Jo nuk mund ta gjej tani.

Z. I. Rusmali: Zoti Merkaj mund ta administrojmë ne shkresën që ju i keni dërguar subjekteve televizive?

Z. Y. Merkaj: Po i nderuar anëtar i KAS-it, kam porositur administratën sapo ta sjellin mund ta keni edhe ju, faleminderit.

Z. I. Rusmali: Kjo është në kronikat e të gjitha mediave. Të gjitha mediat venë shënimin kur japin një kronikë, se kush e ka përgatitur dhe shënimin që materiali filmik i servitur nga subjekti. Ju e keni vënë re këtë gjë?

Z. L. Braho: Ka pyetje tjetër nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Për dijeni të gjithë pjesëmarrësve, në shkresën që ju i keni dërguar atyre i keni bërë të ditur afatin kur duhet të dorëzonin tarifat. Keni bërë ndonjë sqarim që mosdorëzimi i tarifave i ngarkonte me penalitete subjektet?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. Y. Merkaj: Thjesht ne kemi përcaktuar detyrimin ligjor nenin 84 pika 5 ku i kemi përcaktuar që 5 ditë para fillimit të fushatës janë të detyruara të dorëzojnë tarifat në KQZ.

Z. I. Rusmali: Unë kam një pyetje për personin që përfaqëson televizionet, në lajmërimin që keni bërë paraprakisht për subjektet e interesuara a keni afishuar çmime të shërbimeve që ju ofroni apo jo?

Z. M. Gjinaj: Tv Mat është një television prej gati 30 vitesh dhe është me përvojë në këtë fushë. Çdo subjekt politik vjen, bën propozimet e veta dhe kështu e vendosim bashkë.

Z. I. Rusmali: Tek ajo shkresa nuk keni patur shërbime?

Z. M. Gjinaj: Absolutisht jo!

Z. I. Rusmali: Ju nuk keni publikuar paraprakisht çmime, pra mënyra e operimit tuaj është me negociim. Faleminderit, qartë.

Z. M. Gjinaj: Të jap një sqarim, në televizionet tona tarifat vendosen me negociim. Ne ta vendosim sa të duam, partitë politike nuk e pranojnë dhe kërkojnë të hiqen fare sepse nuk kanë mundësi për ta paguar çmimin që vendosim ne. Ky është fakti.

Z. I. Rusmali: Edhe një pyetje tjetër në këtë linjë. Ju keni 30 vite përvojë në këtë histori, negociim me partitë politike për vendosjen e tarifave për reklamat televizive, negociimin e bëni veç e veç apo me të gjithë bashkë?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. M. Gjinaj: Tani kjo është veçori nga një rreth në tjetrin. Për shëmbull në Tv Mat vjen secili më vete sepse po i mbodhe të gjithë nuk mund t'i shpërndash më.

Z. I. Rusmali: Do të thotë, një tarifë me Partinë Socialiste në negociim me ta dhe pastaj një tarifë tjetër me Partinë Demokratike në negociim me ta. Pastaj një me LSI, pastaj një me Legalitetin, pastaj një me kandidatin e pavarur. Pra, secilit tarifën e vet.

Z. M. Gjinaj: Po sipas mundësisë që ka ai për të paguar.

Z. L. Braho: Faleminderit, vijojmë me kërkesën ankimore të rradhës.

Z. Y. Merkaj: Në të njëjtën situatë jemi si tek rasti i mëparshëm edhe për Club Tv. Nuk ka dorëzuar tarifatat zyrtare. KQZ i ka dërguar shkresën për të dorëzuar brenda 5 ditësh tarifatat zyrtare të cilat do të pasqyroheshin tek faqja zyrtare e KQZ-së. Nuk u dorëzuan dhe për këto arsye është penalizuar me gjobën 30 mijë lekë.

Z. L. Braho: Club Tv nuk ka përfaqësues. Çfarë pretendojnë në ankim ata?

Z. Y. Merkaj: Këta pretendojë se nuk kanë marrë reklama nga asnjë parti politike, është në të njëjtat kushte si Tv Mat. Ndaj dhe gjykuam se dorëzimi i tarifave zyrtare është obligim për OSHMA-të që bëjnë këto transmetime.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. L. Braho: Kam unë një pyetje, nga ky raporti që i bashkëlidhet vendimit të Komisionerit a rezulton nëqoftëse këto kanë bërë transmetim reklamash politike apo jo?

Z. Y. Merkaç: Gjatë hetimit gjyqësor jemi fokusuar vetëm tek kjo pjesë dhe nuk kemi shtrirë hetimin tek pjesa tjetër.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! Pyetje ka për këtë? Jo!
Kërkesa ankimore e rradhës?

Z. Y. Merkaç: Është A2 CNN i cili ka rezultuar se e ka tejkaluar minutazhin e reklamave politike të përcaktuara prej 90 minutash. Të cilat përbëjnë mosrespektimin e detyrimit të parashikuar në nenin 84, pika 5 e Kodit Zgjedhor. Për këtë arsye duke qenë se kjo shkelje është parashikuar nga ky kod është dënuar me gjobë 30 mijë lekë, faleminderit.

Z. L. Braho: Ka përfaqësues A2 CNN?

Z. S. Hodo: Po!

Z. L. Braho: Ju lutem prezantohuni.

Z. S. Hodo: Sidi Hodo nga A2 CNN. Me vendimin 224 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ajo që ne ankimojmë është masa administrative. Në bazë të tabelës 1 në shtojcë, A2 CNN ka transmetuar 96.97 minuta praktikisht 6 minuta mbi kufirin e 90 minutëshit. Përtej arsyesimit që mund të jetë thjesht një gabim njerëzor masa

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

administrative nuk i përgjigjet nenit 171, pika 1 e cila përcakton 3 mijë lekë deri në 90 mijë lek masë administrative. Kështu që është një masë administrative jo propocionale me shkeljen prandaj dhe ne kemi kërkuar rivlerësimin e masës administrative.

Z. L. Braho: Pra, ju e pranoni shkeljen por kërkon që të jetë në propocion me shkeljen. Zoti Merkaj është i vërtetë fakti që tejkallimi i minutazhit është bërë vetëm për 6 minuta dhe disa sekonda?

Z. Y. Merkaj: Po është e vërtetë, por është shkelje si 6 minuta si 1 sekondë.

Z. L. Braho: Pretendon për marzhin e dënimit që mos të jetë 30 mijë lekë të reja por të jetë më i vogël.

Z. Y. Merkaj: Po! Në parimin e propocionalitetit meqenëse shkelja ka qenë e vogël, 6 minuta, ne kemi bërë minimumin e gjobës së parashikuar.

Z. I. Rusmali: Pse nuk keni dhënë dënimin siç thotë subjekti në baze të nenit 171, pika 1?

Z. S. Hodo: Më falni, masa administrative ka ardhur 50 mije lekë të reja dhe jo sa thotë zoti Merkaj. Neni 171, pika 1 parashikon 3 mijë lekë deri në 90 mijë lekë të reja.

Z. L. Braho: Ylli është 171/1 dhe është dënuar 50 mijë lekë të reja dhe jo 30 mijë lekë të reja?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. Y. Merkaj: Po! 50 mijë lekë...

Z. L. Braho: Ju kërkoni një masë më të vogël dhe propocionale.

Z. S. Hodo: Shkelja nuk është as 7% e 90 minutëshit.

Z. L. Braho: E kuptova. Ka pyetje nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Dakord, nëse mund të na argumentojnë çfarë arsytimi është ndjekur në vendosjen e masës 50 mije lekë ose ta bëj pyetjen ndryshe nga vëzhgimet tuaja për monitorimin në media të fushatës A2 CNN ka patur shkelje të tjera të ngjashme ose të ndryshme nga kjo kalimi i minutazhit? Për shëmbull prishje të balancës midis palëve, tejkalim në edicionet e lajmeve, ka patur shkelje që ju i keni vënë re?

Z. Y. Merkaj: Gjatë vendimit administrativ vetëm këtu jemi fokusuar, te tejkalimi i minutazhit.

Z. I. Rusmali: As denoncime për A2CNN, as pretendime nga subjektet zgjedhore.

Z. Y. Merkaj: Jo!

Z. L. Braho: Zoti Merkaj pasi u njohëm me pretendimet e palës ankimuese ju si administratë e KQZ-së keni ndonjë mendim në lidhje më ankimin? Çfarë duhet të bëj KAS duke qenë se tejkalimi është vetëm 6 minuta?

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. Y. Merkaj: Unë jam këtu përfaqësues i KQZ dhe i qëndroj vendimit të Komisionerit.

Z. L. Braho: Mirë, faleminderit. Pyetje të tjera ka nga kolegët?

Z. S. Hodo: Më falni, në shtojcën 1 dhe në vendimin 224 janë paraqitur edhe munutazhet e televizioneve të tjera të cilët janë 479 minuta, 201, 289 dhe të gjithë kanë marrë masë administrative të barabartë me A2 CNN.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit. Vazhdojmë me kërkesën ankimore të rradhës.

Z. Y. Merkaj: Për ankimin e OSHMA-së Tv Klaudio jemi në të njëjtën situatë si tek rasti i mëparshëm. Nuk ka dorëzuar tarifata zyrtare. KQZ i ka dërguar shkresën për të dorëzuar brenda 5 ditësh tarifata zyrtare të cilat do të pasqyroheshin tek faqja zyrtare e KQZ-së. Nuk u dorëzuan dhe për këto arsye është penalizuar me gjobën 30 mijë lekë.

Z. L. Braho: Ka përfaqësues ky ankimues?

Z. M. Gjinaj: Pak a shumë 70% jam dakord me pjesën e TV Matit ajo që do të doja të shtoja. Kam njoftuar Kryetarin e KQZ-së sepse Ndua është edhe vetë në Londër dhe godina që ne kemi është në qendër të Peqinit dhe nuk kishte mundësi qoftë teknike që të ofroheshin mundësi për këto zgjedhje. Dukeqënëse ne kemi vite që nuk e njohim subjektin deri sa ka dalë ligji i famshëm që 90 minuta ne jemi të detyruar me ligj të mos vendosim tarifa. Dhe diçka, këto tarifata e famshme ne i kemi bërë tek Tv Mat që kur na vinte ndonjë nga këto kandidatët apo subjektet politike dhe pse

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

ishim njoftuar paraprakisht për të qënë korrekt në bazë të ligjit kanë vite që nuk vijnë, nuk afrohen. Dukeqënëse u bëmë edhe inegzistent dhe as KQZ-ja sna afrohesh përveçse faktit që miku jonë i nderuar Z. Ilirjan Celibashi ka filluar të na ofrojë pak reklamë dhe të kuptojmë çështë institucioni i KQZ-së në raport. me ne. Dhe e fundit le të na nxjerri përfaqësuesi i KQZ-së që ne e paskemi marë atë letrën nga KQZ-ja për të qëndruar korrekt ligjit. Ju falenderoj të gjithëve, kaq kisha.

Z. L. Braho: Pra ju pretendoni që nuk ju ka ardhur njoftimi nga KQZ-ja?.

Z. M. Gjinaj: Unë kam shumë vite që e drejtoj atë televizion dhe po ju'a them sinqerisht që nuk më ka ardhur sepse një letër është nuk ka pagesë. Dhe tjetra kemi një AMA atje qe na ndjek hap pas hapi dhe paska bërë problem për 6 minuta, të tjerët shkojnë 600 minuta dhe nuk i ka gjetur gjë.

Z. L. Braho: Pra dhe ju i qëndroni faktit që nuk keni transmetuar asnjë reklamë politike. Dakord, faleminderit. Ka pyetje nga kolegët?

Z. E. Çefa: Në raportin e AMA-ës rezulton me minutazh subjekti? Është evidentuar apo jo?

Z. Y. Merkaj: Jo nuk është evidentuar!

Z. L. Braho: Vazhdojmë me kërkesën tjetër ankimore.

Z. Y. Merkaj: Në kundërshtim të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 224, ka bërë ankim edhe Radio Saranda Televizion e cila është në të njejtat kushte

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

si tek çështja e parë, nuk ka dorëzuar tarifatat zyrtare dhe për mosrespektim të nenit 84, pika 5 të Kodit Zgjedhor është dënuar me gjobë nga Komisioneri në masën 30 mijë lekë, faleminderit.

Z. L. Braho: Ky kishte një pretendim edhe për emrin me sa vura re nga kërkesa ankimore apo e korigjuam?

Z. Y. Merkaç: Unë e lexova Radio Saranda Televizion.

Z. L. Braho: Dakord, ka përfaqësues Radio Televizioni Saranda?

Administratori i Radio Televizionit Saranda: Mos ta zgjas shumë unë nuk e di nëse kjo masë administrative është për këto zgjedhjet e fundit apo për të gjitha zgjedhjet që janë bërë këto 20 vite.

Z. L. Braho: Për zgjedhjet e 25 Prillit 2021.

Administratori i Radio Televizionit Saranda: Në 20 vjet kanë bërë si të duan, çfarë kanë dashur, me çmime dhe me të gjitha. Në këtë periudhë çfarë fushate u bë? Kush bëri fushatë? Në Radio Televizionin Saranda nuk u bë fushatë.

Z. L. Braho: Pyetja është, keni bërë reklamë ju për zgjedhjet e 25 Prillit 2021?

Administratori i Radio Televizionit Saranda: Jo! Edhe po tu bënte tju tregoj disa emaile që kam dhe që kam debatuar për punë çmimesh. Këta e kanë vënë sa ju ka dashur qejfi.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. L. Braho: Kush këta?

Administratori i Radio Televizioni Saranda: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Z. L. Braho: Zoti Merkaj vendos KQZ-ja tarifa për mediat?

Z. Y. Merkaj: Jo ne vetëm kërkojmë të na tregojnë sa janë tarifat që kanë vendosur.

Z. L. Braho: Ju i keni kërkuar me e-mail?

Z. Y. Merkaj: Po!


Z. L. Braho: Pra ju nuk keni transmetuar asnjë reklamë për zgjedhjet e 25 Prillit 2021?

Administratori i Radio Televizionit Saranda: Më parë po, për zgjedhjet e 25 Prillit jo. Megjithatë subjekti është vendosur gabim, urdhëro ekstratin e QKR-së.

Z. L. Braho: Ajo shkon në favorin tënd nëse është vendosur gabim. Dakord, faleminderit! Vazhdojmë me kërkesën tjetër ankimore.

Z. Y. Merkaj: Shoqëria Tv Berati ka paraqitur ankim kundër vendimit 224 të Komisionit Shtetëror të zgjedhjeve duke e ankimuar këtë vendim. Gjatë shqyrtimit administrativ ka rezultuar se Tv Berati nuk ka dorëzuar tarifatat zyrtare sipas

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

parashikimit të nenit 84, pika 5 të Kodit Zgjedhor dhe për këtë arsye nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është dënuar me gjobë në masën 30 mijë lekë, faleminderit.

Z. L. Braho: Ka përfaqësues të Berati Tv?

Z. M. Gjinaj: Jam unë me autorizimin e gjykatës.

Z. L. Braho: Mund të më sqaroni diçka. Ankimin e ka bërë Tv Berati, gjobën e ka marrë Tv Berati, në çfarë cilësie përfshihet shoqata në këtë autorizimin që të ka dhënë ty?

Z. M. Gjinaj: Shoqata është një OJF e cila ka për detyrë në bazë të statutit të saj, neni 12, pika 2 të përfaqësojë në të gjitha institucionet qeveritare, joqeveritare, gjyqësore, me avokat apo pa të gjithë anëtarët e saj. Mbi këtë bazë kanë ardhur.

Z. I. Rusmali: Neni 12 i statutit çfarë thotë?

Z. M. Gjinaj: Neni 12 i statutit thotë qartë fare, përfaqëson shoqatën e televizioneve në të gjitha institucionet qeveritare për ankesat dhe problematikën që kanë. Ne kemi qenë në kuvendin popullor, kemi qenë në komisionin e medias etj... për të gjitha kërkesat që këto kanë.

Z. L. Braho: Dakord Më fal, nuk është gjobitur shoqata por televizioni në mënyrë individuale. Ka ndonjë autorizim nga këto televizione për shoqatën dhe që shoqata pastaj të autorizon ty?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. M. Gjinaj: Shoqata, për informacionin tuaj, njoftoi televizionet për gjobitjen sepse për ndryshe nuk do të vinin asnjë këtu dhe shoqata është përfaqësuese e tyre për të gjitha gjërat. Ky është arsyeja që shoqata është OJF, nuk është fitimprurëse, thjesht për të mbrojtur këto njerëz, këto subjekte, këto OSHMA.

Z. I. Rusmali: Shiko janë diskutime të ndryshme shoqata të punojë fort dhe ti mbrojnë të gjithë anëtarët e vet kudo ku ato kanë mundësi. Çështja është këtu jemi në një proces administrativ dhe palë në procesin administrativ është subjekti, Tv Berati. Administratori Tv Beratit, Alban Shehu që ka bërë ankimin duhet t'ju jepte një autorizim që për llogari të Tv Beratit ta përfqësonit këtu. Në mungesë të këtij autorizimi ju nuk e përfaqësoni dot.

Z. M. Gjinaj: Unë jam nisur..., se nuk më kushtonte asgjë për të marrë autorizim, nga neni që është miratuar me vendim gjykatë për të përfaqësuar shoqatën, dhe nuk më kushtonte asgjë t'i thoja më bëj një autorizim dhe ma dërgo.

Z. L. Braho: Pra, ju pretendoni që nuk ju ka ardhur njoftimi nga KQZ-ja?

Z. M. Gjinaj: Unë kam shumë vite që e drejtoj atë television dhe po jua them sinqerisht që nuk më ka ardhur sepse një letër është nuk ka pagesë. Dhe tjetra kemi një AMA atje që na ndjek hap pas hapi dhe paska bërë problem për 6 minuta, të tjerët shkojnë 600 minuta dhe nuk i ka gjetur gjë.

Z. I. Rusmali: Ta bëjmë këtë proces të rregullt dhe të qetë. Ne e morëm një vendim, shoqata nuk është subjekt i këtij procesi dhe e mbyllim këtu historinë. Të gjithë subjektet që kanë bërë ankim kanë të drejtë të përfaqësohen, ankesat e të gjitha

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

subjekteve do të shqyrtohen nga ana jonë panvarësisht nëse ato përfaqësohen apo jo. Këto janë rregullat tona. Nuk bëj ankesa për shkak se mungon njeriu, ankesën në e shqyrtojë panvarësisht nga përfaqësuesi I subjektit. Kështuqë ju e keni vullnetin e mirë ti përfaqësoni por sot nuk i përfaqësoni dot sepse ju mungon autorizimi. Në kuptuam që situata e Tv Beratit është identike me situatën e Tv Matit. Nuk është identike në fakt u shpreha gabim, është e ngjashme. Nuk ka transmetuar reklamë elektorale dhe për sa kohë nuk ka transmetuar reklamë elektorale, nuk ka faturuar reklamë elektorale dhe si pasojë nuk e ndjen veten në shkelje të ligjit për deklarimin e tarifave. Kjo është e qartë sic u tha për 3, 4 stacione të tjera televizive. E mbylлим Beratit këtu dhe vazhdojmë tek subjekti tjetër nëse ka përfaqësues apo jo dhe vazhdojmë kështu deri në fund.

Z. L. Braho: Në mungesë të autorizimit nga subjekti ankimues ju nuk legjitimoheni për të parashtruar vendimet në lidhje me ankimin. Të vazhdojë zoti Merkaj me pretendimet e ankuesit.

Z. M. Gjinaj: Mund të shtoj një fjalë të ventme?

Z. L. Braho: Po!

Z. M. Gjinaj: Kjo ka ndodhur sepse qoftë subjektet, qoftë shoqata nuk ka qënë në kokën tuaj se çvendim do të jepni. Në një kohë të dytë kur ta doni, elektronikisht ose pa dalë nga salla ta dërgojnë në KQZ edhe vazhdojmë.

Z. L. Braho: Këto duhet të ishin përgatitur përpara, në momentin që vjen për një procedurë administrative duhet të ishte i pajisur me të gjitha autorizimet e duhura.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Patjetër, ka nje keqkuptim nga ana juaj dhe nuk e di se çfarë është bërë me organet e tjera nëse jua kanë pranuar po ne këtu në mungesë dhe të statutit të shoqatës nuk mund ta marim të mirëqenë që ti je i autorizuar nga kryetari i shoqatës. Këtu do i qëndroj dhe argumentave që dha dhe kolegu im zoti Rusmali. Ne do vijojmë njësoj ti trajtojmë ato pavarësisht faktit që ju flisni apo jo në emër të tyre. Shqyrtimi do të vijojë, nuk është se ndërpritet shqyrtimi meqënëse nuk ka përfaqësues. Vijojmë, zoti Merkaj pretendimet e Tv Beratit.

Z. Y. Merkaj: Kundër vendimit të Komisionerit ka bërë ankim Tv Berati duke parashtruar se bazuar në nenin 137 të Kodit të Procedurave Administrative ka dërguar një email në datën 8 dhjetor 2021 ora 10:20 ku ju kemi vendosur kohën e lejuar të reklamave politike bashkë me tarifat me afat të caktuar. Nuk kemi transmetuar asnje reklamë politike, nuk ka asnjë faturë që të jetë derdhur nga subjektet politike për zgjedhjet e datës 21 Prill 2021. Ky është argumentimi që ka bërë ankuesi në ankim.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! Ka ndonjë pyetje nga kolegët?

Z. E. Çefa: A ka ardhur e-maili? E keni administruar e-mailin?

Z. Y. Merkaj: Ideja është që flitet për një kohë 8 dhjetor që i bie 7, 8 muaj pas zgjedhjeve.

Z. L. Braho: Tek e-maili janë tarifat?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. Y. Merkaj: Kështu thotë pretendimi. Kam dërguar email në datën 8 dhjetor 2021 tarifat e 25 prillit.

Z. L. Braho: Dakord! Nëse nuk ka pyetje, vijojmë me kërkesën tjetër.

Z. Y. Merkaj: Kundër vendimit 224 të Komisionit Shtetësorë të Zgjedhjeve ka paraqitur ankim Globe Tv e cila është në të njëjtat kushte si tek çështja e mëparëshme nuk ka dorëzuar tarifat zyrtare dhe për këtë arsye në bazë të nenit 84, pika 5 e Kodit Zgjedhor është dënuar me gjobë në masën 30 mijë lekë nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, faleminderit.

Z. L. Braho: Faleminderit! Edhe këtu nuk ka përfaqësues sepse jemi në të njëjtin rast si rasti i mëparshëm. Pretendimi i ankimuesit dhe pyetje paraprakisht nëse është evidentuar nga ana e KQZ-së nëse ka transmetuar reklama elektorale apo jo?

Z. Y. Merkaj: Edhe pretendimi i ankuesit është i njëjtë me pretendimet e mëparëshme, nuk ka pasur asnjë kërkesë nga subjektet politike për transmetim dhe në këto kushte nuk e ka parë të arsyeshme që të dorëzojë tarifat zyrtare.

Z. L. Braho: Ka pyetje nga kolegët? Vijojmë me kërkesën tjetër!

Z. Y. Merkaj: Televizioni Tv Alpo ka paraqitur ankim kundër vendimit 224 të Komisionit Shtetësorë të Zgjedhjeve duke pretenduar se nuk ka transmetuar asnjë reklamë politike. Dukeqënëse nuk ka dorëzuar tarifat zyrtare dhe për këtë arsye në bazë të nenit 84, pika 5 e Kodit Zgjedhor është dënuar me gjobë në masën 30 mijë lekë nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. L. Braho: Ka përfaqësues?

Z. A. Petro: Po, Aristotel Petro, përfaqësues i Alpo Televizion, Gjirokastër. Doja të theksoja këtu se në rradhë të parë në lidhje me gjobat që keni vendosur duhet të njihni dhe natyrën e televizioneve lokale. Pasi nuk është e njëjtë natyra e televizioneve lokale me natyrën e televizioneve qendrore. Televizionet qendrore ndoshta nuk marrin reklama sepse partitë politike nuk kanë bërë asnjëherë reklama në asnjë television ose nuk kanë paguar asnjëherë por paguajnë me shpërblime të tjera që ju ndoshta edhe i dini por nuk është rasti ti përmëndni. Megjithatë televizionet lokale janë një çështje mbijetese për shumë shkaqe edhe për shkaqe politike. Sepse politika nuk ka dashur televizione të lira por ka dashur gjithmon televizione të cilat u përgjigjen kërkesave të tyre për të vazhduar që ato të qeverisin pafundësisht në pushtet të shqipëtarëve dhe të bëjnë këtë që po bëjnë shumë mirë duke larguar të gjithë shqipëtarët jashtë vëndit. Megjithatë kjo është një temë tjetër. Në rastin tonë, ne pretendohet se na kanë vendosur gjobë pse nuk kemi deklaruar çmimet. Në rradhë të parë ne nuk na ka kërkuar njeri çmime historikisht dhe reklam në televizionin tonë asnjë parti politike. Edhe në rastet kur kanë pasur nevojë i kanë marrë me dhunë, me forcë dhe me mënyra të tjera televizionet që po të doni unë jua sqaroj se si. Ajo që dua të theksoj është se këtu shikojmë jo vetëm një gjobitje por një lajthitje të grupit që kanë vënë gjoba sepse ne nuk kemi transmetuar ndonjë reklamë që të penalizohemi ose sepse kemi transmetuar X parti politike më shumë se një parti tjetër apo kemi bërë ndonjë shkelje të ligjit. Ne nuk kemi asnjë lloj transmetimi televiziv. Mesa kuptova gjoba qënka vetëm për mosdeklarim të tarifave. Ne tarifat kur na i kanë kërkuar jua kemi nisur. Këtu kemi një shënim të dërguar nga KQZ-ja të datës 7.02.2022 ku na keni kërkuar tarifat dhe çmimet dhe ne

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

jua kemi dërguar. Me dijeninë time nuk ka pasur as ndonjë telefonatë as ndonjë e-mail që unë të kem marrë për të deklaruar çmimet. Megjithatë siç e tha edhe parafolësi nuk është parë asnjëherë të jepën reklama politike sidomos në televizionet skajore siç jemi edhe ne që jemi katandisur me dy persona në staf sepse nuk kemi mundësi as të mbijetojmë pale të paguajmë edhe stafin. Nderkohë që televizionet kombëtare arrijnë vlera marramendëse nga 2, 3 miljonë euro shpenzime në muaj me një staf prej mijëra veta Si ndodhin këto? Këtu duhet të insistojë pyetja pse ka kaq shumë diferencime. Kur KQZ-ja apo ndonjë institucion tjetër publik apo shtetëror ka ofruar qoftë edhe një reklamë të vetme, asnjëherë. Këtu pabarazia dhe diferencimet janë shumë të mëdha sidomos në televizionet që nuk kanë asnjë anësi politike por si qëllim të tyre kanë vetëm informimin e publikut në mënyrë korrekte dhe të paanëshme dhe jo shkuarjen pas njëres apo tjetres parti politike. Në anën tjetër të gjobës nëse e marim kështu e tha edhe parafolësi, ju keni barazuar televizionet kombëtare me televizionet lokale me gjoba të njësojshme a thua se janë në të njëjtin stad kur dihet si funksionojnë këto lloj benefitesh që televizionet kombëtare japin politikanëve të ndryshëm. Madje edhe disa pref stafit tuaj i kemi parë në panele te ndryshme bisedash si flasin dhe si komunikojnë por nuk është rasti këtu të flasim për cilësinë e këtyre bisedave në këto television dhe as për paanshmërinë e tyre, nëse ka apo jo. Kemi rastin që ne të mos bullizohemi dhe të mos fyemi kështu vërdallë me gjoba fiktive kur nuk ka asnjë të drejtë, kur nuk na keni ofruar asnjë lloj mundësie, asnjë lloj informacioni, asnjë lloj bashkëpunimi. Unë mendoj që këto gjëra janë bërë selektive. Këto dhe të tjera mund të flisja pafund për parregullsi të nga drejt anës tonë si media lokale sesa parregullsi nga ana jonë drejt një institucioni shtetërorë apo ndonjë institucioni tjetër. Nëse keni pyetje mund të më bëni zotërinj.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. L. Braho: Faleminderit për të gjitha shqetësimet që parashtruat edhe pse një pjesë nuk ishin fare për në KAS. Megjithatë për të sqaruar diçka gjobën nuk jua ka vënë kjo trupë jua ka vënë një organ tjetër i KQZ-së. Ne vetëm po shqyrtojmë ankimin.

Z. A. Petro: Nuk e kishim me ju.

Z. L. Braho: Me zotin Merkaj, çështje tjetër.

Z. A. Petro: Po! Nuk e kemi me juve.

Z. L. Braho: Gjithsesi, faleminderit! Ka pyetje nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Ju përmendët një komunikim të shkurtit 2022-it për tarifa.

Z. A. Petro: Po!

Z. I. Rusmali: Jua ka kërkuar KQZ-ja me shkresë dhe ju i keni dhënë përgjigje?

Z. A. Petro: Po na i ka kërkuar me shkresë.

Z. I. Rusmali: Me Ç'rast është dërguar kjo shkresë?

Z. A. Petro: Nuk e di me ç'rast por na ka ardhur një kërkesë.

Z. I. Rusmali: Ka pasur zgjedhje lokale në Gjirokastrë?

Z. A. Petro: Jo, nuk ka patur.

Z. I. Rusmali: Në 6 Mars në Gjirokastrë?

Z. A. Petro: Jo nuk ka patur.

Z. I. Rusmali: Pse shkresë atëherë?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. A. Petro, përfaqësues i TV Alpo-së: Në momentin që na është dërguar ne jua kemi kthyer përgjigjen, por nuk na ka kushtuar asgjë të kthejmë një përgjigje dhe çudia më e madhe është se kurrë një subjekt politik nuk na ka kërkuar një spot publicitar në 22 vjet që ne kemi si media. Nuk na ka kërkuar kurrë një spot publicitar.

Z. I. Rusmali: Qartë, komunikim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në zgjedhjet e 2021-shit nuk keni pasur?

Z. A. Petro, përfaqësues i TV Alpo-së: As komunikim, as mbështetje, as informacion dhe asgjë tjetër historikisht, jo vetëm për zgjedhjet e 2021-shit. Kurrë deri më sot, përveç emailit që na ka ardhur, që i kemi kthyer përgjigje.

Z. L. Braho: Faleminderit, nëqoftëse nuk ka pyetje tjetër vijojmë me kërkesën ankimore të rradhës.

Z. Y. Merkaj: TV Apollon ka dorëzuar ankim kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, 224. Gjatë shqyrtimit administrativ ka rezultuar se TV Apollon nuk ka dorëzuar tarifata zyrtare. Referuar Nenit 24, pika 8, Kodi Zgjedhor, Komisioneri ka vlerësuar se për shkelje të dispozitave të mësipërme, të gjobitet me 30.000 (tridhjetë mijë) lekë gjobë, faleminderit.

Z. L. Braho: Ka transmetur reklamë TV Apolloni?

Z. Y. Merkaj: Jo.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. L. Braho: Viojmë me kërkesën tjetër.

Z. Y. Merhaj: Në të njëjtat kushte jemi dhe me TV Koplik-un. Nuk ka dorëzuar tarifat zyrtare. Gjatë hetimit administrativ Komisioneri ka vlerësuar se ka bërë shkelje të Nenit 24, pika 8 dhe e ka gjobitur me masën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.

Z. L. Braho: Çfarë pretendimesh ka ankimuesi? Apo edhe ankimuesi këtu të njëjtat pretendime që nuk ka transmetuar reklamë, nuk ka patur kërkesë.

Z. Y. Merhaj: Është i njëjti arsyetim. Nuk ka patur shkelje subjekti, nuk ka asnjë dokument që të ketë derdhur në subjektin zgjedhor për zgjedhjet e datës 21 prill 2021.

Z. L. Braho: Dakord faleminderit, viojmë me kërkesën tjetër.

Z. Y. Merhaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin numër 224, datë 07.12.2022, ka gjobitur televizionin Best Channel për tejkalim të minutazhit nga radiotelevizionet private, për më shumë se 90 minuta dhe e ka gjobitur me masën e gjobës 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Sa A2-shi, por ky e ka më pak shkeljen, e ka 1.6 minuta.

Z. L. Braho: TV Best Channel është gjobitur për tejkalim. Sa është gjoba?

Z. Y. Merhaj: 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Z. E. Çefa: Më falni ky subjekti është televizion kombëtar apo televizion lokal?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. Y. Merkaçaj: Lokal.

Z. I. Rusmali: Përfaqësuesi i A2 CNN-it, nuk e di sa jeni teknik juve apo jeni jurist?

Z. S. Hodo, përfaqësues i A2 CNN: Jurist.

Z. I. Rusmali: Nuk e di sa keni mundësi të na shpjegoni këtë histori me diskortancë.

Z. S. Hodo, përfaqësues i A2 CNN: Atëherë, duke qenë se përpara përpilimit të ankesës pata dhe bordin e kolegëve, duke qenë se transmetimi kryhet me sistem të dixhitalizuar, nga sistemi jonë i dixhitalizuar minutazhi duhet të ishte më pak , por duke qenë se raporti i AMA-së ka qenë i para një viti dhe kishin kaluar afatet për të ankimuar minutazhin, atëherë dhe objekti i ankesës është kryer vetëm përsa i përket pjesës së proporcionalitetit. Realisht në bazë të anës teknike të dhënë nga kolegët, ka qenë më pak sesa 19 minuta, të paktën pjesa që nxjerr sistemi, e regjistruar në mënyrë automatike.

Z. I. Rusmali: Dakord, ky është rasti juaj që pretendoni...Unë doja të dija më shumë teknikisht si ndodh. Se duket sikur edhe TV-ja tjetër, Best Channel , edhe ky duket sikur e ka patur në vëmendje 19 minutëshin që i ka rrëshqitur në 91, por edhe ju duket sikur e keni patur në vëmendje.

Z. S. Hodo, përfaqësues i A2 CNN: Në vëmendje ka qenë. Sistemi na ka raportuar më pak. Fakti që nuk është ankimuar, prandaj dhe bëra parantezën që nuk është

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

ankimuar pjesa e minutazhit. Është se mbase për shkak të kolegëve të mi, sepse nuk kanë qenë të vëmendshëm, sepse dhe matja e minutazhit të AMA-së është raporti ditor i AMA-së dhe duhet të jetë dikush i fokusuar në raportin ditor të AMA-së dhe të mati të gjithë minutazhin. Në fund të muajit, të raportit gjatë fushatës elektorale, të dimë nëse sipas AMA-së është brenda 19 minutëshit ose nuk është brenda 19 minutëshit.

Z. I. Rusmali: Një pyetje për Yllin. Ka dhe subjekte të tjera, dëgjuam nga shtjellimet e përfaqësuesit të A2 CNN, që kanë pasë tëjkalime të limitit edhe me minutazh të lartë. Ato kanë marrë gjoba apo jo? Nuk janë këtu sepse nuk janë ankuar apo jo?

Z. Y. Merkaj: Nuk janë ankuar, por kanë marrë gjoba.

Z. I. Rusmali: Gjoba për ta sa ka qenë? Për të gjithë uniforme.

Z.Y.Merkaj: Po, për të gjitha është marrë e njëjta masë.

Z. I. Rusmali:E dimë limitin e minutazhit të tejkalluar për ta, domethënë diapazonin. Nga më i vogli tek më i larti. Nuk më duhet kush janë , por më duhet vetëm të kuptoj, ata që janë të vetëdijshëm për shkeljen, sa janë.

Z. Y. Merkaj: Jo, kemi evidentuar vetëm keta që janë me ankim. I kemi për ti pasur, por nuk i kam për momentin. Ndoshta do të ishte mirë për ne ta kishim një tabelë.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. S. Hodo, përfaqësues i A2 CNN: E kemi ne tabelën.

Z. I. Rusmali: Mirë, mund të na e vini ju në dispozicion? Ju keni të drejtë të na vini në dispozicion provat tuaja.

Z. S. Hodo, përfaqësues i A2 CNN: Gjithsesi sa për informacion është nga 91.6 deri në 550.

Z. I. Rusmali:Dakord, faleminderit!

Z. E. Çefa: Këtë pyetje më mirë do e sqaronte përfaqësuesi i AMA-së që ne e kërkuam herën tjetër që ta kishim prezent, por meqenëse ato nuk e kanë parë të arsyeshme që të na nderojnë me pjesëmarrjen, unë po pyes përfaqësuesit e televizioneve dhe ndoshta hetimi do të marrë përgjigje. Në metodologjinë e monitorimit që aplikon AMA për minutazhin e reklamave politike, a ka ndonjë marsh tolerance të gabimit njerëzor ose edhe të gabimit elektronik të aparaturave? Më bëj një paraalelizëm me matjen e shpejtësisë në qarkullimin rrugor, ku vetë aparatura e ka një 5% tolerancë gabimi. Aparaturat e AMA-së sipas metodologjisë, a e parashikojnë këtë? Ka ndonjëri ndonjë sqarim, di ndonjëri...

Përfaqësues i ERA Dixhitalb: Atëhere AMA në përgjithësi kur monitoron, fillon dhe monitoron me sistemin dixhital dhe monitoron për të gjithë njësoj. Pra, secili televizion futet në monitorim edhe monitorohet gjatë gjithë kohës, sidomos për detyrimin që ka, sepse neve paralelisht na njofton me shkresë çdo subjekt dhe shoqatë, që do të monitoroj nga dita e parë deri në ditën që mbyllet fushata. Në këtë, monitorimi është në përgjithësi i saktë, por kur vjen puna për 1 minutë e 6

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

sekonda, ai bën vaki nuk shtyp butonin. Ore është 3 metra larg, e kalon duke filmuar vetë edhe nuk është. Kështu që kjo është pak a shumë, por në përgjithësi monitorimi është dixhital dhe është i saktë. Ky është realiteti. Me qenë unë them për të tjerët që kanë shkuar 400 minuta ose kanë shkuar 90, 1 minutë nuk kap dot stirolapsin e ta marrësh të shkruash ose do të shtypësh një buton. Gabimi del tek aparati që ka bërë monitorimin. Merr specialist që ta monitorojë. Ai ka çertifikatën mbrapa dhe thotë kaq përqind gabim. Aparatet që ka AMA janë të Bashkimit European .

Z. L. Braho: Kam një pyetje për përfaqësuesin e A2-shit. Ju referuat se ju ka ikur afati për ankimin e pjesës së minutazhit. Kur jeni vënë në dijeni ju për pjesën e minutazhit? Jeni vënë në dijeni përpara vendimarrjes së Komisionerit?

Z. S. Hodo, përfaqësues i A2 CNN: Jo, vetëm në datën 7 dhjetor, pra që është data e vendimit të gjykatës.

Z. L. Braho: Pra nëpërmjet këtij vendimi jeni vënë në dijeni dhe për shkeljen e minutazhit me...

Z. S. Hodo, përfaqësues i A2 CNN: Me 6 minuta.

Z. L. Braho: Dakord, vijojmë me kërkesën e rradhës.

Z. Y. Merkaç: Era Dixhitalb nuk ka dorëzuar tarifat. Për këtë arsye nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, duke qenë se ka shkelur nenin 84, pika 5 e Kodit Zgjedhor, është dënuar me gjobë në masën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. L. Braho: Ka transmetuar reklama?

Z. Y. Merkaj: Jo.

Z. L. Braho: Viojtmë me kërkesën tjetër.

Z. Y. Merkaj: Të njëjtat përsëriten edhe me televizionin Kukës. Nuk ka dorëzuar tarifën. Për këtë arsye është shkelur neni 24 pika 5 i Kodit Zgjedhor dhe nga Komisioneri është dënuar me gjobë në masën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.

Z. L. Braho: Kjo është kërkesa e fundit? ka pyetje nga kolegët?

Përfaqësues i TV Kukësi: ... i televizionit Kuksi.

Z. L. Braho: Më fal meqenëse tek autorizimi ishte autorizimi.

Përfaqësues i TV Kukësi: Autorizimi (nuk dëgjohet). Ne për të na njoftuar na ka njoftuar sekretare e shoqatës. Ne asnjë nuk kemi njoftuar.


Z. L. Braho: Patjetër ju mund të flisni.

Përfaqësues i TV Kukësi: Ndërsa unë i kam shkruar një shkresë KQZ-së.

Z. L. Braho: Nga kush nuk jeni njoftuar?

Përfaqësues i TV Kukësi: Nga KQZ-ja.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. L. Braho: As për shqyrtim, ndoshta audjo...

Përfaqësues i TV Kukësi: Jo jo, vetëm na kanë njoftuar. Unë u ndodha këtu, këtu isha dhe pacjent dhe thashë hajt se po vij. Ne kemi bërë dhe kërkesë televizionit lokal nga televizioni rajonal, pavarësisht se jam në gjyq me TVSH-në për 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë. Më kanë bllokuar sinjalin, jam në gjyq me atë, ma ka prurë shpirtin në majë të hundës, Televizioni Shqiptar. Erdha këtu për tu përfaqësuar se aktualisht në Kukës nuk ka patur zgjedhje. Tarifat e vitit 2017 i kam dërguar në KQZ.

Z. L. Braho: Flasim për zgjedhjet e 2021-shit.

Përfaqësues i TV Kukësi: Në 2021-shin në Kukës nuk ka patur zgjedhje. Unë kam qenë i bllokuar nga RTSH-ja, nuk kam patur...

Z. L. Braho: Zgjedhje ka patur në të gjithë Shqipërinë në 25 prill.

Përfaqësues i TV Kukësi: Në Kukës nuk ka patur, nuk ka patur kandidat.

Z. L. Braho: 25 Prill 2021, ne jse ju keni transmetuar reklama?

Përfaqësues i TV Kukësi: Jo, nuk kemi transmetuar asnjë reklamë.

Z. L. Braho: Keni ndonjë pretendim tjetër në lidhje me gjobën?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Përfaqësues i TV Kukësi: Pretendim se pse na u vu gjoba aktualisht. Vetëm sepse nuk kemi çuar tarifat e 2021-shit? Aktualisht edhe njëherë kërkesë nga ana juaj, që jeni anëtarë të trupit...Të paktën merrni parasysh televizionet. Gjithë televizionet janë të përfshirë në AMA, se si transmetojnë dhe se si a kanë licencën. Aktualisht atë buxhet që e kam kërkuar edhe me shkresë. I kam kërkuar në 2021-shin që të na shpjegoni se ku kanë shkuar ato lekët e buxhetit për reklamat e KQZ-së dhe nuk na ka kthyer përgjigje.

Z. L. Braho: Mirë, falemiderit!

Z. E. Lako: Në mos gaboj, në 2021 ju keni qenë të bllokuar si televizion.

Përfaqësues i TV Kukësi: Po të bllokuar.

Z. E .Lako: Nuk keni qenë në aktivitet?

Përfaqësues i TV Kukësi: Jo.

Z. E. Lako: Faleminderit! Po ndonjë dokument keni ju për këtë?

Përfaqësues i TV Kukësi: Jam në gjyq me RTSH-në me mbi 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë të reja ku AMA e shtyu trasmetimin nga Shtatori, shtyu dhe shtatorin, ajo preu faturën.

Z. I. Rusmali: Të lutem mos na e komplikoj. Në periudhën janar-prill të 2021-shit ka transmetuar televizioni?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.17.01.2023

Përfaqësues i TV Kukësi: Në Kukës po, Në Tiranë jo.

Z. I. Rusmali: Në Kukës.

Përfaqësues i TV Kukësi: Në Kukës po, kam transmetuar në Kukës se jam lart ndaj.

Z. I. Rusmali: Domethënë keni patur probleme me sinjalin në Tiranë, në Kukës keni transmetuar.

Përfaqësues i TV Kukësi: Kam patur probleme me sinjalin në Tiranë dhe jam në gjyq më RTSH-në. Në Kukës kam transmetuar, por nuk kam transmetuar reklamë.

Z. L. Braho: Faleminderit, ka ndonjë përfaqësues tjetër që nuk është dëgjuar në lidhje me kërkesën ankimore? Jo. Atëherë, KAS do të tërhiqet në lidhje me marrjen e vendimit për të gjitha kërkesat ankimore siç u relatua në këtë seancë dhe shpallja e vendimit do të bëhet në datën 23 janar 2023 në orën 12:30. Seanca deklarohet e mbyllur.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

